



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data	
Nr. Prot	

RELACION
PËR
PROJEKTVENDIMIN
PËR

“PËRDORIMIN E PAJISJES ELEKTRONIKE TË IDENTIFIKIMIT TË ZGJEDHËSVE, NË ZGJEDHJET E
PJESSHME PËR KRYETAR TË BASHKISË KUKËS, TË DATËS 24 SHTATOR 2023”.

I. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI

Neni 14, pika 2, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ka parashikuar përgjegjësinë e Nënkomisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për përcaktimin e zbatueshmërisë dhe drejton punën për zbatimin e projektit të identifikimit elektronik të votuesve. Ai bashkushtron me të drejta të barabarta me Komisionerin, kompetencat për përzgjedhjen, monitorimin dhe zbatimin e teknologjisë për identifikimin elektronik të zgjedhësve

Neni 20, pika 1, shkronja “ë”, i Kodit Zgjedhor, ka parashikuar kompetencën e Komisionit Rregullator për të shqyrtuar dhe miratuar projektaktet me karakter normativ, të përgatitura nga administrata e KQZ-së ose nga anëtarët e tij, për rregullat për përdorimin e sistemeve apo pajisjeve të teknologjisë së informacionit, të domosdoshme për të siguruar përdorimin e ligjshëm, të rregullt, transparent, efikas dhe të qëndrueshëm të tyre.

Neni 22 pika 4, i Kodit Zgjedhor ka parashikuar Kompetencat e KQZ-së lidhur me teknologjinë në zgjedhje. Sistemet ose pajisjet e teknologjisë së informacionit që KQZ-ja vendos të përdoren në zgjedhje duhet të synojnë, në radhë të parë, identifikimin elektronik të votuesve dhe verifikimin paszgjedhor të tyre, votimin me dhe nëpërmjet pajisjeve elektronike dhe numërimin nga pajisjet të votave të hedhura, si dhe të jenë të aplikueshme së paku për pesë procese zgjedhore të njëpasnjëshme



II. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTVENDIMIT

Në zbatim të detyrimeve të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në këtë projektvendim parashikohet përdorimi i pajisjeve elektronike të identifikimit (PEI) në të gjitha qendrat e votimit, për të kryer identifikimin elektronik të zgjedhësve në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023.

Ngarkohet me përgjegjësi për zbatimin e këtij projektvendimi, Administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Për sa më sipër në këtë relacion, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nëpërmjet administratës së KQZ, i propozon Komisionit Rregullator për shqyrtim dhe miratim projektvendimin “Për përdorimin e pajisjes elektronike të identifikimit të zgjedhësve, në zgjedhjet e pjesshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023”.

Sekretar i Përgjithshëm

Ylli MERKAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI RREGULLATOR

Data: .8.2023 | Nr: | Ora:

PROJEKTVENDIM

PËR

**PËRDORIMIN E PAJISJES ELEKTRONIKE TË IDENTIFIKIMIT TË ZGJEDHËSVE, NË ZGJEDHJET E
PJESHME PËR KRYETAR TË BASHKISË KUKËS, TË DATËS 24 SHTATOR 2023**

Në mbështetje të Dekretit të Presidentit nr. 186, datë 11.8.2023, "Për caktimin e datës së zgjedhjeve për Kryetar të Bashkisë Kukës", nenit 14, pika 2, nenit 20, pika 1, shkronjat "ë", dhe nenit 22, pika 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe Nënkomisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator

V E N D O S I:

1. Në zgjedhjet e pjeshme për Kryetar të Bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023, procesi i identifikimit të zgjedhësve të kryhet nëpërmjet pajisjeve elektronike të identifikimit (PEI) në të gjitha qendrat e votimit.
2. Ngarkohet administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor, pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Ilirjana NANO Kryetar

Arens ÇELA Anëtar

Dritan ÇAKA Anëtar

Helga VUKAJ Anëtar

Muharrem ÇAKAJ Anëtar

Data: .8.2023 Nr:
Ora:



"Për përdorimin e pajisjes elektronike të identifikimit të zgjedhësve, në zgjedhjet e pjeshme vendore për Kryetari të Bashkisë Kukës, të datës 24 shtator 2023"